

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	5 interpelanca sot në Kuvend, protestë jashtë Parlamentit - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/sot-seance-plenare-ne-kuvend-priten-5-interpelanca-proteste-jashte-parlamentit/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHÀ


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 06:16:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 06:11:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ea5fddde2e5ac56fc87a13c3cf334a9074985c0e235e0afd249ad320ca1f968e
TEKSTI	894656871b8d7601691573e4a8334497ffa988a8f99a3eb024a72adf8b786535
PAMJA	301509df77d7f4ea65bb1d4f212254bac490873e79c359970ffc33c308a624ee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b6a47f889d641219426a9e942f3acab72eb93119d15235b6d9f2ceae43847096
E MËPARSHMJA	ab053920709c5cee3aa8877cff2be05664b951a27c77459ad3344ecd4494b047
RRËNJA MERKLE	7552192d4562aa207666eadcaed525346db194fc39c694c2be0ac3ebbafe5dc8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b6a47f889d641219426a9e942f3acab72eb93119d15235b6d9f2ceae43847096>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Inteligjenca Artificiale Donald Trump Integrimi ne BE Protesta në Tiranë

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

5 interpelanca sot në Kuvend, protestë jashtë Parlamentit

17 Shtator 2026 | 08:11

Këtë të enjte do të zhvillohet në orën 10:00 seanca e radhës plenar në Kuvend. Gjithashtu jashtë Parlamentit do të mbahet një protestë nga qytetarët. Seanca do të nisë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare të datës 8 shtator, ndërsa në rendin e ditës janë parashikuar pesë interpelanca urgjente të kërkuara nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

E para është me Ministrin e Mjedisit, Sofjan Jaupaj, e dyta me Ministrin e Punëve të Brendshme, ndërsa interpelancat e tjera janë me Ministren e Arsimit, Mirela Kumbaro, dhe Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu.

Po ashtu, deputeti Blendi Himçi ka kërkuar një interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi.

Në vijim, deputetët do të shqyrtojnë një sërë projektligjesh, mes tyre projektligjin për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, të bërë në Hagë më 16 dhjetor 2025.

Në rendin e ditës është përfshirë edhe projektligji për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës.

Kuvendi do të shqyrtojë gjithashtu projektligjin për pranimin e vendimit të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit për ndryshimin e nenit 36 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjë të Tavolinës, 2015.

Një tjetër pikë e rëndësishme e rendit të ditës është projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ky projektligj kërkon shumicë të cilësuar votash për miratim.

Në seancë do të shqyrtohet edhe projektligji "Për disenjot", si dhe projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike".

Në fund të seancës do të hidhen për votim tre projektvendime që lidhen me ndryshimet në kryesinë, anëtarësinë dhe anëtarët zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit. Seanca do të mbyllet me diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës.

LAJMI I FUNDIT

08:23 Cilat janë hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Gjykatës Speciales?

08:20 Moti i keq godet Spanjën, një viktimë në Katalonjë! Paralajmërimi dhe kaos në transport (VIDEO)

08:19 Rachida Dati në gjykatë, ish-ministrja franceze në gjyq për çështjen e korrupsionit

SHPËRNDARJE Benault-Nissan
ARTIKULLIN

08:10 Trump: Irani kontaktoi drejtpërdrejt SHBA-në, dëshiron të arrijë një marrëveshje

07:38 Brenda propozimit të von der Leyen për një arkitekturë të re të sigurisë së BE-së

07:22 BE rikonfirmon angazhimin për zgjerim, Kos: Një union më i madh do të jetë një union më i fortë

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

Tafani: Po të ishte gjallë Adem Jashari, do ishte dënuar

Analisti Endri Tafani ka kritikuar ashpër vendimin e gjykatës lidhur me ish-pjesëtarët e UÇK-së. Tafani ka ngritur shqetësimin se UÇK-ja po trajtohet tashmë jo si...

23:04 | 16/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

Konstitucionalisti Daci: Ja si mund të zhbëhet vendimi i Hagës

Jordan Daci jurist, ka folur në "Now" lidhur me mundësinë e ndryshimit të vendimit në Apel sa i përket dënimit me 81 vite burg në...

22:27 | 16/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

Vuçiç i zhgënjyer nga Haga, Bido: U viktimizua, ishte shumë i kënaqur me vendimin

Deputeti i Partisë Socialiste, Ardit Bido ka diksutuar në "Now" mbi vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për dënimin me 81 vite burg në total...

22:10 | 16/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontakttoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: